LIGJ
Nr.9417, datë 20.5.2005

PËR DISA SHTESA NË LIGJIN NR.8894, DATË 14.5.2002 "PËR AGJENCINË E TRAJTIMIT TË KREDIVE", I NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr.8894, datë 14.5.2002 "Për Agjencinë e Trajtimit të Kredive", i ndryshuar, bëhen këto shtesa:

Neni 1

Pas nenit 6 shtohet neni 6/1 me këtë përmbajtje:

"Neni 6/1

Agjencia paguan taksën për veprimet që kryhen nga përmbaruesi gjyqësor në fund të ekzekutimit dhe në raport me shumën e ekzekutuar.

Agjencia përjashtohet nga taksat për veprimet që kryhen nga zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të luajtshme.".

Neni 2

Në nenin 7, pas fjalëve "ose nuk janë të kontrolluara nga shteti", shtohet fjalia me këtë përmbajtje:

"Agjencia ka të drejtën e kalimit kapital të aseteve të veta, sipas dispozitave ligjore në fuqi.".

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.4607, datë 1.6.2005 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu